



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr.976/_____Prot.

Tiranë, më _____2016

1 NJOFTIMI I KONTRATËS

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë
Adresa: Bulevardi "Bajram Curri" Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel/Faks: +355 4 2376178
Personi i Kontaktit: Z. Raimond Cimbi
Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve, Investimeve dhe Koncesioneve,
Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë
Bulevardi "Bajram Curri" Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Email: Raimond.Cimbi@shendetesia.gov.al
Faqja e internetit: www.shendetesia.gov.al

Çdo komunikim, pyetje ose kërkesë për informacion nga Ofertuesit, në lidhje me Procedurën e Konkurruese, do t'i drejtohet Personit të Kontaktit.

1.2 Lloji i Autoritetit Kontraktues dhe objekti i aktivitetit të tij ose aktivitetet kryesore

Institucion Qendror

1.3 Lloji i Kontratës së Koncesionit

Shërbime

1.4 Përmbledhje e kushteve kryesore të Kontratës së Koncesionit

Objekti i Kontratës: Financimi, projektimi, rinovimi, pajisja, riorganizimi dhe funksionimi i Koncesionin/Partneritetin Publik Privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale, dhe atyre bashkiake të Sarandës e Lushnjës.

Forma e Kontratës: Partneritet publik privat për shërbime publike

Burimi i Financimit të Projektit: Buxheti i shtetit nëpërmjet Spitaleve subjekt i kësaj kontrate.

Tarifa e koncesionit që do të paguhet nga Koncesionari: asnjë.

1.5 Afati i Kontratës së Koncesionit

10 vjet duke filluar nga Data e Vënies në Funkcion (e përcaktuar në Kontratën e Koncesionit).

1.6 Vendndodhja e Objektivit të Kontratës

Spitalet e renditura në Shtojcën 23 te Dokumenteve te Koncesionit/PPP.

1.7 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik (Dokumentet e Kualifikimit)

Sipas Seksionit 8 të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

Vetëm Ofertat e Ofertuesve të Kualifikuar do të vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

1.8 Sigurimi i Ofertës

Në momentin e Afatit të Dorëzimit, Ofertuesit paraqesin Sigurimin e Ofertës (pra 2% e vlerës së përlllogaritur të Projektit, të përcaktuar në paragrafin 1.17.) në shumën 260,119,320 ALL (dyqind e gjashtëdhjetë milion njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet) e cila mund të konvertohet në Euro duke përdorur kursin e këmbimit ALL – EUR të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datën e publikimit të njoftimit të kontratës.

1.9 Procedura Konkurruese

E hapur

1.10 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit

Ofertuesi fitues përzgjidhet ndër Ofertuesit e Kualifikuar, sipas kriterëve të vlerësimit dhe metodologjisë së vendosjes së pikëve, të përcaktuar në Shtojcën 11 (*Kriteret e vlerësimit dhe Metodologjia e Vendosjes së Pikëve*).

Ofertuesi paraqet një Propozim Teknik, siç përcaktohet në Shtojcën 26 (*Formulari i Ofertës Teknike*) dhe ofron një Zbritje Uniformë në Përqindje (me tre shifra pas presjes dhjetore) për tarifën e analizave laboratorike të përcaktuara në Shtojcën 1 (*Formulari i Ofertës Financiare*). Tabela e pikëve është si më poshtë:

Kriteri #	Përshkrimi	Pikë (pikët maksimale)
1	Rrjeti laboratorik bashkëqendror (<i>hub and spoke</i>), dhe Sistemi i Informacionit Laboratorik dhe Sistemi logjistikës	10
2	Plani i Zbatimit të Projektit dhe Riinvestimi	15
3	Burimet Njerëzore dhe Plani i Trajnimit	10
4	Planin i Objekteve dhe Pajisjeve, qasja e mirëmbajtjes dhe strategjia e zëvendësimit gjatë afatit të kontratës	10
5	Plani i menaxhimit të cilësisë dhe metodologjia për kryerjen e analizave	15
	TOTALI	60

Pikët për ofertën financiare

Oferta financiare vlerësohet deri në 40 pikë, ku zbritja më e madhe e çmimit për testet merr pikët maksimale.

Pikët përfundimtare

Rezultati i pikëve të ofertës teknike i shtohet pikëve të ofertës financiare nga ku del rezultati i pikëve totale, deri në 100 pikë.

1.11 Afati i Dorëzimit të ofertave

Data: 15 shkurt 2017

Ora: 15:00 Ora e Evropës Qendrore

Vendi www.app.gov.al

Ofertuesit duhet të dorëzojnë ofertat në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze, të shoqëruar me përkthimin zyrtar në shqip, në mënyrë elektronike, duke e ngarkuar atë, përpara Afatit të Dorëzimit, në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, www.app.gov.al.

Udhëzimet në shqip dhe anglisht për ngarkimin e Ofertës në faqen zyrtare të internetit gjenden në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, www.app.gov.al.

1.12 Hapja e Ofertave

Datë: 15 shkurt 2017

Ora: 15:00 Ora e Evropës Qendrore

Vendi www.app.gov.al

1.13 **Periudha e Vlefshmërisë së Ofertave**

Ofertë është e vlefshme për një periudhë prej 150 ditë nga Afati i Dorëzimit (“**Periudha e Vlefshmërisë së Ofertave**”).

Oferta e Ofertuesit Fitues do të jetë e vlefshme deri në Datën e Nënshkrimit të Kontratës dhe Autoriteti Kontraktues do të mund të kërkojë që Oferta e një Ofertuesi të Kualifikuar të pasuksesshëm të shtyhet deri në Datën e Nënshkrimit të Kontratës.

1.14 **Gjuha**

Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këto Dokumente të Procedurës Konkurruese, gjuha e Ofertave do të jetë gjuha Shqip. Dokumentet e Procedurës Konkurruese publikohen në gjuhën shqipe dhe angleze, në rast mospërputhje apo paqartësie, ka përparësi gjuha shqipe.

1.15 **Kostot**

Dokumentet e Procedurës Konkurruese mund të shkarkohen elektronikisht, pa pagesë, nga faqja zyrtare e APP-së, www.app.gov.al.

Çdo Ofertues përballon kostot dhe shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e Ofertës së tij. Gjithashtu, shpenzimet për koston e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, për sa i përket përgatitjes së dokumentacionit dhe shërbimeve të specializuara të këshillimit për transaksionin, në vlerën e 600,000 EUR (gjashtëqind mijë EUR) do të mbulohen nga Ofertuesi i Fitues dhe do t’i paguhet direkt IFC-së, në përputhje me dispozitat e Kontratës së Koncesionit. Koncesionari do të rimbursojë edhe kostot e Autoritetit Kontraktues në lidhje me shpalljen e njoftimit të kontratës, në vlerën 357,330 lekë brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e Formularit të Njoftimit të Ofertuesit Fitues.

Referuar pikës 7-të VKM-se nr.150, datë 22.03.2007, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve“, ofertuesi fitues përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paguaje tarifën 30,000 Euro.

1.16 **Tarifa e ankimit**

Tarifa për tu paguar nga Ofertuesi për dorëzimin e një ankimi përpara Komisionit të Prokurimit Publik është e barabartë me 26,011,932 ALL (njëzet e gjashtë milion e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) që përfaqëson 10% të Sigurimit të Ofertës.

1.17 **Vlera e Kontratës (Projektit) llogaritur bazuar në mbështetjen financiare të parashikuar për gjithë kohëzgjatjen e kontratës.**

13,005,966,000 ALL (trembëdhjetë miliardë e pesë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) (pa TVSH)¹

1.18 **Monedha**

Ofertuesi do të paraqesë ofertën e tij në monedhën Lekë (ALL).

1.19 **Data e Shpalljes së Njoftimit të Kontratës**

22 dhjetor 2016

MINISTRI

ILIR BEQAJ

¹Ky numër përfaqëson vlerën e parashikuar të Projektit pa TVSH